



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 6019/2 Prot

Rrëshen më, 14 . 12 . 2025

V E N D I M

Nr. 98 datë 10.12.2025

P Ë R

**“MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2026 DHE DOKUMENTIT PËRFUNDIMTAR TË
PROJEKT BUXHETIT AFATMESËM 2026 - 2028”, BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pikat 1/1 shkronja “b”, pika 1/1.3 shkronja “a” dhe “c” nenit 41, nenit 54, shkronja “dh”, nenit 55, pikat 3, dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), neneve 6, 15, 17 & 32, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 140, nenit 149, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, në ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin nr. 8, datë 28.02.2025, e ministrit Financave dhe Ekonomisë, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028”, Udhëzimin Plotësues nr. 19, datë 10.07.2025, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028”, shtojca nr. 5, për Bashkitë që operojnë në SMBV, në VKB nr. 112, datë 27.12.2024, “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetin vjetor 2026”, VKB nr. 60, datë 01.08.2025, “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”, në Udhëzimin e Brendshëm nr. 2, datë 18.08.2025, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028”, shkresën nr. 15867 prot, datë 06.11.2025 të MF, Drejtoria e Përgjithëshme e Buxhetit, Drejtorisë së Financave Vendore për vitin 2026, pas Dëgjësave Publike në çdo njësi administrative të Bashkisë Mirditë, Relacionit nr. 5917 prot, datë 25.11.2025, përgatitur nga Koordinatori i Konsultimit Publik, Relacionin nr. 6019 prot, datë 02.12.2025, mbi detajimin e planit të buxhetit – 2026 dhe PBA 2026-2028, së bashku me projekt/vendimin nr. 6019/1, datë 02.12.2025 i Kryetarit të Bashkisë; Komisioni i Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit, në mbledhjen e datës 9.12.2025, ora 09.30, shqyrtoi draft buxhetin e vitit 2026. të Bashkisë Mirditë, për t’a kaluar në mbledhjes të Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Të miratojë Buxhetin e Bashkisë Mirditë, për vitin 2026, dhe Dokumentin Përfundimtar të Projekt - Buxhetit Afatmesëm 2026 - 2028, të detajuar si më poshtë vijon;

**A. PLANET PËR VITIN 2026, TRANSFERTË E PAKUSHTËZUAR, TRANSFERTË
SEKTORIALE DHE TË ARDHURA TË PARASHIKUARA:**

NR	EMËRTIMI	SHUMA LEKË
1	TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR	291 819 867
2	RRITJA E NIVELIT TË PAGAVE	66 741 320
3	TRANSFERTA SPECIFIKE	245 745 905
4	TË ARDHURAT E PLANIFIKUARA	88 131 000
	TOTALI (1+2+3+4)	692 438 092

ADRESA: SHESH: “ABAT DOÇI”, RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

B. SHPENZIMET TË NDARA SIPAS KATEGORIVE:

	PROGRAMI	600	601	602	604	606	231	TOTALI
		Paga, shpërblime & tjera Personeli	Sigurimet shoqërore & shëndetësore	Mallra dhe shërbime	Transferta të brendshme	Transferta për buxh. famil. & indiv.	Aktive të grupëzuara	
AA133	Aparati dhe Drejtimi i Bashkisë	103 651 176	17 090 189	26 569 813	-	200 000	5 300 000	152 811 178
AB133	Punët Publike dhe Mirëmbajtja	81 829 208	13 807 428	23 243 922	-	-	56 400 000	175 280 558
AC133	Siguria Publike	52 634 478	8 781 040	6 024 665	1 500 000	-	3 000 000	71 940 183
AD133	Arsimi, Shërbimi Social, Kultura dhe Sporti	156 092 198	26 172 000	29 020 671	-	3 220 000	5 350 000	219 854 869
AE133	Bujqësia, Veterinaria dhe Pyjet	39 408 783	7 185 534	2 771 000	-	-	19 185 538	68 550 855
RK133	Fondi Rezervë dhe Kontigjencë	-	-	-	4 000 000	-	-	4 000 000
	TOTALI	433 615 843	73 036 191	87 630 071	5 500 000	3 420 000	89 235 538	692 437 643

2. TË MIRATOJË TABELAT PËRFUNDIMTARE TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESEM 2026 – 2028

VITI 2026

NR	EMËRTIMI I SHPENZIMEVE	SHUMA NË LEKË	%
1	Paga dhe Sigurime	506 652 034	73.17 %
2	Shpenzime Operaive	87 630 071	12.65 %
3	Investime	89 235 538	12.88 %
4	Fond i Emergjencës	1 500 000	0.22 %
5	Fond Rezervë dhe Kontigjence	4 000 000	0.58 %
	TOTALI	692 437 643	

VITI 2027

NR	EMËRTIMI I SHPENZIMEVE	SHUMA NË LEKË	%
1	Paga dhe Sigurime	521 722 455	73.76 %
2	Shpenzime Operaive	98 876 016	13.92 %
3	Investime	81 157 538	11.48 %
4	Fond i Emergjencës	2 000 000	0.28 %
5	Fond Rezervë dhe Kontigjence	4 000 000	0.56 %
	TOTALI	707 256 009	

NR	EMËRTIMI I SHPENZIMEVE	SHUMA NË LEKË	%
1	Paga dhe Sigurime	523 382 555	71.91 %
2	Shpenzime Operative	103 121 591	14.17 %
3	Investime	95 299 538	13.10 %
4	Fond i Emergjencës	2 000 000	0.27 %
5	Fond Rezervë dhe Kontigjence	4 000 000	0.55 %
	TOTALI	727 803 684	

3. Bashkia nga buxheti i saj do të mbulojë shpenzimet për karburant sipas kalendarit të ndeshjeve, siguracion jete, federim, pjesëmarrje në kualifikim e dy ekipeve sportive;

✚ Ekipi Mirdita; volejbol për femra të rritura

✚ Ekipi Mirdita; volejbol për femra të rejtat

4. Të gjitha të dhënat janë të sqaruara dhe të detajuara në relacion mbi detajimin e planit të buxhetit për vitin 2026, tabelat e buxhetit dhe PBA 2026-2028 dhe të regjistruara në sistemin SMBV, (pjesë përbërse e këtij vendimi bashkëlidhur).

5. Plani i miratuar do të detajohet në muaj.

6. Për zbatim e këtij vendimi ngarkohet; Kryetari i Bashkisë Mirditë, (drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe tatim takasave, drejtoria e burimeve njerëzore, juridike, prokurimeve dhe marrëdhënieve me qytetarët, drejtoria e planifikimit, zhvillimit të territorit dhe strehimit, agjencia e inspektimit, kontrollit dhe emergjencave, agjencia e punëve publike, mirëmbajtjes, agjencia e bujqësisë dhe administrimit të pyj dhe njësitë administrative).

Ky vendim hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë dhe i shtrinë efektet financiare, nga data **01 janar 2026**.


SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ




KRYETAR

Aleksandër PICAKU



ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË

Nr. 6019/1 Prot

Datë 2/12/2025

P/V E N D I M

Nr. 103 datë 02/12.2025

**“PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TE VITIT 2026 DHE DOKUMENTIT
PERFUNDIMTARE TE PROJEKT BUXHETIT AFATMESEM 26-28”**

Ne mbështetje të ligjit nr. 139/2015" Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikes e Shqiperise", ligj nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ne projekt-ligjin e buxhetit te vitit 2026 , në udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr.23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore" I ndryshuar , Udhëzimin e MF, nr.08, datë 28.02.2025 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2026-2028", udhezimit plotesues nr.19, date.10.07.2025 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2026-2028", shtojca nr.5 per bashkite qe operojne ne SMBV, vkb nr.112, date.27.12.2024 "Per miratimin e kalendarit te përgatitjes se programit buxhetore afatmesem 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026", ne vkb nr.60, date.01.08.2025 "Per miratimin e tavaneve perfundimtare te shpenzimeve te programit buxhetor afatmesem 2026-2028", udhezimin e brendshem nr.02, date.18.08.2025, "Per përgatitjen e programit buxhetore afatmesem vendore 2026-2028", në shkresën e MF, Drejtorisë e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtorisë së Financave Vendore, nr.15867 prot, datë.06.11.2025 "Dergohet per njoftim transferta e pakushtezuar e pergjithshme dhe sektoriale per vitin 2026",

Këshilli i Bashkisë pasi shqyrtoi projekt-vendimin e paraqitur nga kryetari i Bashkisë Mirditë;

V E N D O S I

I-TE MIRATOJE BUXHETIN E BASHKISE PER VITIN 2026 ME TE DHENAT SI ME POSHTE(TE DHENAT SIPAS SITEMIT TE SMBV):

**A.PLANET PER VITIN 2026 TRANSFERTE E PAKUSHTËZUA ,TRANSFERT
SEKTORIALE DHE TË ARDHURA TË PARASHIKUARA:**

NR	EMERTIMI	SHUMA LEKE
1	TRANSFERTA E PAKUSHTEZUAR	291 819 867
2	RRITJA E NIVELIT TE PAGAVE	66 741 320
3	TRANSFERTA SPECIFIKE	245 745 905
4	TE ARDHURAT E PLANIFIKUARA	88 131 000
	TOTALI(1+2+3+4)	692 438 092

B.SHPENZIMET TE NDARA SIPAS KATEGORIVE;

PROGRAMI	600	601	602	604	606	231	TOTALI
	Paga, Shpërblime & Tjera Personeli	Sigurimet Shog. & Shëndetësore	Mallra dhe Shërbime	Transferta të Brendshme	Transferta për Buxh. Famil. & Indiv.	Aktive të Trupëzuara	
AA133 Aparati dhe Drejtimi i Bashkisë	103 651 176	17 090 189	26 569 813	0	200,000	5 300 000	152 811 178
AB133 Punët Publike dhe Mirëmbajtja	81 829 208	13 807 428	23 243 922	-	-	56 400 000	175 280 558
AC133 Siguria Publike	52 634 478	8 781 040	6 024 665	1,500,000	-	3 000 000	71 940 183
AD133 Arsimi, Shërbimi Social, Kultura dhe Sporti	156 092 198	26 172 000	29 020 671	-	3 220 000	5 350 000	219 854 869
AE133 Bujqësia, Veterinaria dhe Pyjet	39 408 783	7 185 534	2 771 000	-	-	19 185 538	68 550 855
RK133 Fondi Rezervë dhe Kontigjencë	-	-	-	4,000,000	-	-	4,000,000
TOTALI	433 615 843	73 036 191	87 630 071	5 500 000	3 420 000	89 235 538	692 437 643

II TE MIRATOJE TABELAT PERFUNDIMTARE TE PROGRAMIT BUXHETORE AFATMESEM 2026-2028

2026

Emertimi i shpenzimit	Shuma ne leke	%
Paga dhe sigurime	506 652 034	73.17%
Shpenzime Operative	87 630 071	12.65%
Investime	89 235 538	12.88%
Fond i Emergences	1 500 000	0.22%
Fond Rezerve dhe Kontigences	4 000 000	0.58%
Totali	692 437 643	

2027

Emertimi i shpenzimit	Shuma ne leke	%
Paga dhe sigurime	521 722 455	73.76%
Shpenzime Operative	98 876 016	13.92%
Investime	81 157 538	11.48%
Fond i Emergences	2 000 000	0.28%
Fond Rezerve dhe Kontigences	4 000 000	0.56%
Totali	707 256 009	

2028

Emertimi i shpenzimit	Shuma ne leke	%
Paga dhe sigurime	523 382 555	71.91%
Shpenzime Operative	103 121 591	14.17%
Investime	95 299 538	13.10%
Fond i Emergences	2 000 000	0.27%
Fond Rezerve dhe Kontigences	4 000 000	0.55%
Totali	727 803 684	

III-Bashkia nga buxheti i saj do të mbulojë shpenzimet për karburant sipas kalendarit të ndeshjeve, siguracion jete, federimin, pjesmarrje në kualifikim e dy ekipeve sportive:

1. Ekipi Mirdita Volejboll për Femra të rriturat.
2. Ekipi Volejbollit për femra të rejtat.

Te gjitha te dhenat jane te sqaruara dhe te detajuara ne relacionin dhe tabelat e buxhetit dhe PBA 2026-2028(bashkelidhur) dhe te regjistruara, ne sistemin e SMBV..

IV-Per zbatim te ketij vendimi ngarkohet kryetari i bashkise

SEKRETARI

Gaspër TOPOLLAJ

KRYETARI

Aleksander PICA KU

Paraqiten projektin

Dr.Zhvill ekon dhe tatim taksave:V.Gjoka

Pergj.sekt.finan/buxhet:F.Fufi

Juriste::L.Gjergji

KRYETARI
Albert MËLYSHI





BASHKIA MIRDITË

Nr. 6019 Prot.

Rrëshen, me 02/12/2025

RELACION

“MBI DETAJIMIN E PLANIT TË BUXHETIT PËR VITIN 2026” dhe PBA 26-28

Ne mbështetje të ligjit nr. 139/2015" Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 “Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikes e Shqiperise”, ligj nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ne projekt-ligjin e buxhetit te vitit 2026 , në udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr.23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”I ndryshuar , Udhëzimin e MF, nr.08, datë 28.02.2024 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2026-2028”, udhezimit plotesues nr.19, date.10.07.2025 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2026-2028”, shtojca nr.5 per bashkite qe operojne ne SMBV, vkb nr.112, date.27.12.2024 “Per miratimin e kalendarit te përgatitjes se programit buxhetore afatmesem 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026”, ne vkb nr.60, date.01.08.20254 “Per miratimin e tavaneve perfundimtare te shpenzimeve te programit buxhetor afatmesem 2026-2028”, udhezimin e brendshem nr.02, date.18.08.2025, “Per përgatitjen e programit buxhetore afatmesem vendore 2026-2028”, në shkresën e MF, Drejtorisë e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtorisë së Financave Vendore, nr.15867 prot, datë.06.11.2025 “Dergohet per njoftim transferta e pakushtezuar e pergjithshme dhe sektoriale per vitin 2026” , detajimi I buxhetit te vitit 2026 eshte bere si me poshte:

**A. PLANET PËR VITIN 2026 TRANSFERTË E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME ,
PLANI I TË ARDHURAVE VENDORE DHE TRANSFERTË E PAKUSHTËZUAR
SEKTORIALE:**

NR	EMERTIMI	SHUMA LEKE
1	TRANSFERTA E PAKUSHTEZUAR	291 819 867
2	RRITJA E NIVELIT TE PAGAVE	66 741 320
3	TRANSFERTA SEKTORIALE	245 745 905
4	TE ARDHURAT E PLANIFIKUARA	88 131 000
	TOTALI(1+2+3+4)	692 438 092

-Formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme, përcaktohet në nenin 24 të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”. Formula identifikon nevojat për shpenzime të bashkive duke u bazuar tek popullsia relative, dendësia e popullsisë (që reflekton diferencat në koston e ushtrimit të funksioneve ndërmjet bashkive) dhe tek numri faktik i fëmijëve në kopshte dhe nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në bashki. Përveç ekualizimit të kostove të shërbimeve që bëhet nëpërmjet komponentit të dendësisë, formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar sjell edhe ekualizimin e kapacitetit fiskal (të matur nga të ardhurat)

Në transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme është përfshirë edhe efekti që rrjedh nga shtesa e pagave, që rezulton si pasojë e zbatimit, të vkm nr.503, datë.01.08.2024, “Për disa ndryshime në vendimin numër 328, datë.31.05.2023 të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, në shumën 66 741 320 lekë.

-Transferta e pakushtëzuar sektoriale përfshin financimin për funksionet e reja të transferuara në nivel vendor në vitin 2016 sipas Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”. Fondet për këto funksione nuk ndahen sipas formulës së ndarjes së transfertës së pakushtëzuar të përcaktuar në nenin 24 të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”. Fondet për këto funksione ndahen për çdo funksion.

TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORILE E NDARË SIPAS FUNKSIONEVE

NR	EMËRTIMI	SHUMA LEKË
1.	RRJETI RRUGOR RURAL	24 613 226
2.	ARSIMI PARASHKOLLORE	105 035 172
3.	ARSIMI MESËM I PËRGJITHSHËM	12 064 835
4.	KONVIKTI	24 891 547
5.	MBROJTJA NGA ZJARRI	38 256 000
6.	ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE	22 095 423
7.	MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS DHE UJITJES	18 789 702
8.	MBROJTJA CIVILE	0
	TOTALI(1+2+3+4+5+6+7+8)	245 745 905

-TË ARDHURAT VENDORE JANË SIPAS PLANIT TË SJELLË NGA DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE TATIM TAKSAVE TË BASHKISË, SEKTORI I TATIM TAKSAVE.

Të dhënat të ndara sipas strukturave dhe zërave të shpenzimeve operative dhe investimeve, janë bërë duke u mbështetur në shpenzimet faktike të vitit 2025 si orientim, në kërkesat buxhetore sipas drejtorive dhe agjencive të bashkisë të sjella nga DEMP.

Per pagat e bashkise(ketu nuk eshte perfshire APPM), jemi mbeshtetur ne te dhenat e plotesuara nga punonjesja e pagave me tabelat perkatese, sipas secilit program dhe kod produkti, dhe numri i punonjesve sipas vendimit te Kryetarit te Bashkise nr.02, date.08.01.2024 "Per miratimin e struktures organike te Bashkise Mirdite per vitin Buxhetore 2024".

Per Angjencine e Puneve Publike dhe Mirmbajtjes te dhenat per pagat dhe numrin e punonjesve jane sjell me tabele perkatese, te nenshkruar nga nepunesi zbatues dhe autorizues i ketij institucioni. dhe konkretisht si më poshtë:

B. ANALIZA E NDARË SIPAS KODEVE, EMËRTIMEVE TË PROGRAMEVE DHE KAPITUJVE PËR TRANSFERTE TE PAKUSHTEZUAR, TË ARDHURAT E PLANIFIKUARA DHE TRANSFERTE SEKTORIALE:

1. PROGRAMI AA133 APARATI I BASHKISE DHE DREJTIMI I BASHKISE

Këtu përfshihen:

- Funksioni 111 "Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi"
- Funksioni 614 "Planifikimi urban vendorë"
- Funksioni 066 "Strehimi social"

Përgjegjës për përmbushjen e detyrave të këtij programi sipas funksioneve janë:

- a. Kryetari dhe stafi i tij mbështetes
- b. Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe tatim taksave
- c. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Territorit
- d. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Marrëdhënieve me qytetarët

Aktivitet për përmbushjen e këtij programi janë si më poshtë.

Vështrim i përgjithshëm

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax: (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

Zhvillimi i njësisë, menaxhimi i financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera si dhe të burimeve njerëzore, funksionimi i proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimi me publikun. Shërbime në mbështetje të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të këshillit;

Kodi i programit	Emri i Programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
AA133	Aparati i Bashkisë dhe drejtimi i bashkise	• Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të përgjithshme për personelin; • Shërbime të përgjithshme publike, si: shërbimet e prokurimit, mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësia, parqe qendrore automjete, zyra të printimit dhe IT etj; • Administrim, funksionim dhe ofrimi i shërbimeve të mbështetjes për kryetarin e njësisë vetëqeverisjes vendore, për këshillin dhe komisionet e këshillit ose të kryetarit të njësisë; • Shërbimet statistikore dhe baza e të dhënave vendore; • Prodhim dhe përhapje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit.
		• Administrim i çështjeve dhe shërbimeve financiare dhe fiskale; menaxhim i fondeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore etj; • Operacionet e thesarit të njësisë, zyra e buxhetit, administrata e të ardhurave, shërbimet e kontabilitetit dhe auditit; • Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik për çështjet dhe shërbimet financiare dhe fiskale.
		• Administrimi i fondeve të gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore.
		• Pagesat e interesave për borxhin publik të njësisë vendore; • Amortizimi i huave të marra etj. • Zhvillim, përditësim, bashkërendim dhe monitorim i planeve të zhvillimit urbanistik; • Planifikim, administrim, zhvillim dhe kontrolli i territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj; • Grante, hua ose financime për të mbështetur zgjerimin, përmirësimin ose mirëmbajtjen e stokut të banesave; • Lëshimi i lejeve për ndërtime të reja; zhvillimi i tokës dhe veprimtari të tjera që ndikojnë në urbanistikën e njësisë së vetëqeverisjes vendore; • Administrim, bashkërendim dhe monitorim i planeve të përgjithshme, planeve, programeve dhe buxheteve të lidhura me strehimin;

		• Shpërndarje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet e strehimit; • Sigurimi i truallit të nevojshëm për ndërtime banesash; ndërtim ose blerje dhe rimodelim i njërive banuese për publikun në përgjithësi ose për njerëz me nevoja të posaçme; eliminim i ndërtimeve të degraduara i lidhur me sigurimin e strehimit; • Planifikim i përgjithshëm duke përfshirë formulimin, përditësimin, bashkërendimin dhe monitorimin, të Planeve të Përgjithshme Vendore /Planeve të Zhvillimit Strategjik; • Hartimi i planeve të zonimit dhe i rregullave të ndërtimit; • Hartim, administrim, bashkërendim dhe monitorim i politikave të përgjithshme, planeve, programeve dhe buxheteve që lidhen me shërbimet për komunitetin; • Administrim i çështjeve dhe shërbimeve për zhvillimin e komunitetit;
--	--	---

Në këtë program janë funksione që paguhen vetëm me transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat e bashkisë

Të dhënat në shifra sipas funksioneve dhe zërit të shpenzimit:

funksioni 111	Shuma në lekë
Pagat nga Granti	85 249 243
Pagat nga Te ardhurat	11 004 533
Sigurime Shoqerore nga Granti	15 854 823
Shpenzime operative nga Granti	20 555 000
Shpenzime operative nga Te ardhurat	5 144 813
TOTALI	137 808 412

funksioni 614	Shuma në lekë
Pagat nga Granti	5 247 400
Pagat nga Te ardhurat	2 150 000
Sigurime Shoqerore nga Granti	1 235 366
Shpenzime operative nga Te ardhurat	2 620 000
TOTALI	9 102 266

funksioni 066	Shuma në lekë
----------------------	----------------------

Bonus qeraje grand(vlerë e lënë nga fondi I bashkisë për të pastrehët, për % që mbulohet me fondet tona, pasi pjesa tjetër ëelet nga MFE)	600,000
TOTALI	600,000

Zërat në total për programin:

	Programi AA133	Shuma në lekë
600	Paga	103 651 176
601	Sigurime Shoqerore	17 090 189
602-606	Shpenzime operative	26 769 813
	TOTALI	147 511 178

Sqarojmë se të gjitha keto të dhëna janë edhe analitikisht në tabelat bashkëlidhur relacionit.

2. PROGRAMI AB133 PUNET PUBLIKE DHE MIREMBAJTJA

Ky program përfshin të gjitha shërbimet publike sipas specifikimeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore me funksionet si me poshtë:

- funksioni 452 Rrjeti rrugor rurale
- funksioni 510 Menaxhimi i mbetjeve
- funksioni 626 Shërbime publike vendore
- funksioni 644 Ndriçimi i rrugëve
- funksioni 633 Furnizimi me ujë

Përgjegjes për funksionimin e këtij programi dhe përmbushjen e detyrave të tij është Agjensia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes dhe për një pjesë të investimeve Bashkia.

Këtu theksojmë se nga kjo agjenci me fuqinë punëtore sipas strukturës përkatëse kryhen pjesa më e madhe e shërbimeve , që ka si detyrim bashkia ndaj komunitetit dhe konkretisht:

a- Shërbimi i pastrimit, me të cilin mbulohet pjesa më e madhe e territorit të bashkisë, bëhet më mjetet dhe fuqine puntore të bashkisë, kostoja e të cilave mbulohet nga të ardhurat dhe transfertat e pakushtëzuar. Në shpenzime përfshihen:

-Pagat e punonjësve

-sigurimet shoqërore dhe shëndetsore

-karburanti për automjetet që janë pjesë e kryerjes së shërbimit të pastrimit

-shpenzimet për shërbimin e mirmbajtjes së automjeteve që janë pjesë e kryerjes së shërbimit të pastrimit si pjesë këmbimi, goma, siguracione, taksat, ndërhyrje në raste defektesh në situata emergjente.

-blerja e koshave

-vegla pune

-blerje klori për koshat

b- Shërbimi i gjelbërimit i cili kryhet në qytetet Rrëshen, Rubik dhe Reps. Në shpënzime përfshihen:

-pagat e punonjësve

-sigurimet shoqërore dhe shëndetsore

-blerje vegla pune

-shpenzime mirmbajtje sipërfaqe të gjelbërta dhe pemët dekorative

c- Dekori i qytetit që përfshin shpenzimet në raste festash, për dekoret.

d- Mirmbajtja e ndriçimit rrugor

e- Mirmbajtja e infrastrukturës së territorit dhe objekteve të bashkisë, rurale dhe urbane duke kryer të gjitha shërbimet me fuqinë puntore të APPM-së.

Aktivitetet për përmbushjen e këtij programi janë si më poshtë:

Vështrim i përgjithshëm		
Sigurimi i ofrimit të shërbimeve publike vendore		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
AB 133	Punet Publike dhe Mirembajtja	• Planifikim i përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave si: rekreacioni, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin; • Mbjellja e luleve, shkurreve dhe pemëve dekorative, të cilat përmirësojnë hapësirën e gjelbërt të njësive të vetëqeverisjes vendore; • Zëvendësimi i trotuareve të prishura me material cilësorë që përmirëson hapësirën publike dhe rrit cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve; • Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit; • Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike; • Të gjitha shërbimet e tjera publike sipas specifikimeve të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore;

		• Administrim, instalim, vënie në funksionim, mirëmbajtje, përmirësim i ndriçimit të rrugëve, mjediseve publike; • Zhvillimi, rregullimi dhe përmirësimi i standardeve të ndriçimit rrugor. • Administrim, mbikëqyrje, inspektim organizim ose mbështetje e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve; • Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake; • Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e këtyre sistemeve; • Pastrimi i rrugëve, parqeve etj. • Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, tunele, parkime, terminale autobusësh, rrugë këmbësore dhe korsi biçikletash etj.) dhe sinjalizimi rrugor i trotuareve dhe shesheve publike vendore nën administrimin dhe përgjegjësië e njësisë së vetëqeverisjes vendore; • Studime për rehabilitimin, përmirësimin, ndërtime të reja në sistemet e transportit për rrjetin rrugor nën administrimin e njësisë vendore; • Marrja e masave për lehtësimin e trafikut dhe kontrollin e sistemit rrugor rural të njësisë vendore; • Administrim i problemeve të furnizimit me ujë; • Mbikëqyrje dhe disiplinim i të gjitha problemeve të furnizimit me ujë, duke përfshirë pastërtinë e ujit, çmimin dhe kontrollet e sasisë; • Ngritja ose vënia në funksionim e kapaciteteve të zgjeruara në shërbimin lokal të furnizimit me ujë • Prodhim dhe shpërndarje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet e furnizimit me ujë • Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve të furnizimit me ujë.
--	--	--

Në këtë program janë funksione që paguhen me transfertën e pakushtëzuar përgjithshme të ardhurat e bashkisë dhe transfertat sektoriale për Rrjeti rrugor rural në shumën 23 889 188 lekë

Të dhënat në shifra sipas funksioneve dhe zërit të shpenzimit:

funksioni 452	Shuma në lekë
Paga nga grandi	11 670 622
Pagat nga Te ardhurat	3 452 000
Paga nga Transferta sektoriale	24 613 226
Sigurime Shoqerore nga Granti	6 802 884
Shpenzime operative nga Granti	7 393 922
Shpenzime operative nga Te ardhurat	3 700 000
TOTALI	57 632 654

funksioni 510	Shuma në lekë
Pagat nga Granti	21 028 960
Pagat nga Te ardhurat	5,000,000
Sigurime Shoqerore nga Granti	4 321 788
Shpenzime operative nga Granti	1 808 094
Shpenzime operative nga Te ardhurat	4 091 906
TOTALI	36 250 748

funksioni 626	Shuma në lekë
Pagat nga Granti	13 564 400
Pagat nga Te ardhurat	2,500,000
Sigurime Shoqerore nga granti	2 682 756
Shpenzime operative nga Granti	1 350 000
TOTALI	20 097 156

funksioni 644	Shuma në lekë
Shpenzime operative nga Granti	1 700 000
TOTALI	1 700 000

Zërat në total për programin:

	Programi AB133	Shuma në lekë
600	Paga	81 829 208
601	Sigurime Shoqerore	13 807 428
602-606	Shpenzime operative	23 243 922
	TOTALI	118 880 558

Sqarojmë se të gjitha keto të dhëna janë edhe analitikisht në tabelat bashkëlidhur relacionit. Gjithashtu në këtë program janë përfshirë edhe dy punonjës të cilët paguhën me fondet të cilat i sponsorizon Seka Hydropower shpk sipas kontratës së miratuar me vendimin e Keshillit Bashkiak numer 53, datë.03.06.2024 “Per miratimin e kontratës së dhurimit ndërmjet shoqërisë koncesionare Seka Hydropower” shpk dhe Bashkisë Mirdite, i ndryshuar me vkb numer 76, datë.25.09.2025 “Per një ndryshim në vkb numer 76, datë.25.09.2024”, ku fondet do të çelen në kapitullin 06 e ardhur jashtë limitit.

3. PROGRAMI AC133 SIGURIA PUBLIKE

Ky program përfshin funksionet si më poshtë:

- funksioni 314 Shërbimin e policisë vendore,
- funksioni 328 Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri
- funksioni 614 Inspektoriatin Ndërtimor,
- funksioni 563 Ndërgjegjesimi mjedisor(inspektoriatin i mjedisit).
- funksioni 091 Emergjencat civile

Përgjegjës për këtë program është Agjencia e Inspektimit, Kontrollit dhe Emergjencave.

Në këtë program janë funksione që paguhën me transfertën e pakushtëzuar përgjithshme të ardhurat e bashkisë dhe transfertat sektoriale që është shërbimi i mbrojtjes nga zjarri 38 255 551 lekë.

Sqarojmë se në këtë program janë shtuar (2+5), punonjës nga të cilët dy janë egzistues dhe deri në fund të vitit 2025 janë paguar nga transfertat e pakushtëzuar të bashkisë, ndërsa me buxhetin e vitit 2026 do paguhën me transfertën sektoriale dhe 5 punonjës do të rekrutohen të rinj në sektorin e MZSH-se.

Per rrjedhojë fondi i pagave dhe sigurimeve në këtë program, në produktin V328AAA “Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri” ka ndryshuar nga 23 963 132 leke buxheti i vitit 2025, në 33 210 886 leke buxheti i vitit 2026.

Aktivitetet për përmbushjen e këtij programi janë si më poshtë

Vështrim i përgjithshëm		
Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve policore që janë të nevojshme për kryerjen e funksioneve në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbrojtjes së punëve publike, parandalimin dhe zbulimin e informalitetit brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Masa të njësisë së vetëqeverisjes vendore për të rritur besimin e qytetarëve dhe marrëdhënien e njësisë me komunitetin. Për qëllime bashkëpunimi njësi vendore planifikon aktivitete të cilat ndihmojnë në ofrimin e shërbimeve sa më afër kërkesave dhe nevojave të qytetarëve.		
Kodi i	Emri i Programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit

programit		
AC133	Siguria Publike	• Sigurimi i mbrojtjes, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore, kur nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror; • Ekzekutimi dhe zbatimi i akteve të nxjerra nga Kryetari i Njësisë dhe i vendimeve të Këshillit të Njësisë. • Funksionimi i njësive zjarrfikëse dhe i shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit; • Mbështetja e programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit; • Shërbime të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit; • Mbrojtja Civile dhe administrim i strukturave përkatëse; Shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmytura etj. • Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm për mbrojtjen dhe ndërgjegjësimin mjedisor.

Të dhënat në shifra sipas funksioneve dhe zërit të shpenzimit

funksioni 314	Shuma në lekë
Pagat nga Granti	8 424 489
Pagat nga Te ardhurat	2,000,000
Sigurime Shoqerore nga Granti	1 740 890
Shpenzime operative nga te ardhurat	520 000
TOTALI	12,890,452

funksioni 328	Shuma në lekë
Pagat nga Granti	0
Paga nga Transferta sektoriale	28 458 332
Sigurime Shoqerore nga Granti	0
Sigurime Shoqerore Transferta sektoriale	4 752 554
Shpenzime operative Transferta sektoriale	5 044 665
TOTALI	28 255 551

funksioni 614	Shuma në lekë
Pagat nga Granti	2 975 080
Pagat nga Te ardhurat	500,000
Sigurime Shoqerore nga Granti	580 338
Shpenzime operative nga te ardhurat	170 000
TOTALI	4 225 418

funksioni 563	Shuma në lekë
Pagat nga Granti	3 080 824
Pagat nga Te ardhurat	500,000
Sigurime Shoqerore nga Granti	597 998
Shpenzime operative nga te ardhurat	150 000
TOTALI	4 328 822

funksioni 091	Shuma në lekë
Pagat nga Granti	4 695 753
Paga nga të ardhurat	2,000,000
Sigurime Shoqerore nga Granti	1 109 260
Shpenzime operative te ardhurat	140 000
TOTALI	7 945 013

funksioni 091	Shuma në lekë
Fondi I emergjencave civile	1,500,000
TOTALI	1,500,000

Ky fond është lënë në këtë masë pasi pjesa tjetër çelët nga Ministria e Mbrojtjes, gjithashtu fond emergjence janë çelur edhe 3 000 000 leke për ndryshime emergjente në formë investimi.

Zërat në total për programin:

	Programi AC133	Shuma në lekë
600	Paga	52 634 478
601	Sigurime Shoqerore	8 781 040
602-606	Shpenzime operative	6 024 655
604	Fondi I emergjencave civile	1,500,000
	TOTALI	68 940 183

Sqarojmë se të gjitha keto të dhëna janë edhe analitike në tabelat bashkëlidhur me relacionin.

4. PROGRAMI AD133 ARSIMI, SHERBIMI SOCIAL, KULTURA DHE SPORTI

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax: (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

Ky program përfshin funksionet si më poshtë:

- funksioni 912 Arsimit bazë dhe parashkollor
- funksioni 923 Arsimit parauniversitar (arsimi i mesëm)
- funksioni 923 Arsimit parauniversitar (konviktet)
- funksioni 813 Sport dhe argëtim
- funksioni 822 Shërbimet kulturore
- funksioni 014 Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara
- funksioni 476 Turizmi
- funksioni 043 Përkujdesja për fëmijët (çerdhet)

Përgjegjes për funksionimin e këtij programi është Agjencia e Arsimit, Sportit dhe Ndhmës Sociale, Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Muzeve

Në këtë program janë funksione që paguhet me transfertën e pakushtëzuar përgjithshme të ardhurat e bashkisë dhe transfertat sektoriale që është :

-Arsimi bazë dhe parashkollorë.....105 035 172 lekë

-Arsimi i mesëm.....12 374 835 lekë

-Konviktet.....24 891 547 lekë

Aktivitetet për përmbushjen e këtij programi janë si më poshtë

Vështrim i përgjithshëm		
Mbështetja e arsimit parashkollor dhe arsimit bazë, administrim dhe rregullim i sistemit arsimor parashkollor në kopshte.		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
AD133	Arsimi, Shërbimi Social, Kultura dhe Sporti	• Shpenzime për paga për mësuesit e kopshteve të fëmijëve dhe stafit mbështetës; • Programe mësimore për trajnimin e edukatorëve dhe mësuesve; • Furnizimi dhe mbështetja me ushqim e kopshteve; • Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave shkollore. Ndërtim dhe mirëmbajtje e institucioneve shkollore; • Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndërtesave arsimore e sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale; • Ndërtim dhe mirëmbajtje konviktesh. • Përfitime monetare ose në natyrë, si asistencë

		për detyrat e përditshme për personat përkohësisht të paaftë për punë për shkak sëmundjeje ose dëmtimi (ndihmë shtëpiake, lehtësi transporti etj.); • Përfitime monetare ose në natyrë për personat që janë plotësisht ose pjesërisht të paaftë të merren me veprimtari ekonomike ose të bëjnë një jetë normale për shkak të një gjymtimi fizik ose mendor; • Përfitime në natyrë, si: vakte ushqimi që u jepen personave të paaftë në ambiente të përshtatshme, ndihmë që u jepet personave të paaftë për t'i ndihmuar në detyrat e përditshme (ndihmë shtëpiake, lehtësi transporti etj.), pagesë ditore për personin që kujdeset për personin e paaftë, trajnim profesional e trajnim tjetër i dhënë për të nxitur rehabilitimin në punë dhe atë shoqëror të personave të paaftë, shërbime dhe përfitime të ndryshme dhënë personave të paaftë, për të marrë pjesë në veprimtari kulturore dhe zbavitëse ose për të udhëtuar apo për të marrë pjesë në jetën e komunitetit; • Administrim, vënie në funksionim ose mbështetje për skema të mbrojtjes shoqërore. • Shpenzimet për mbulimin e shërbimit të çerdheve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore
--	--	---

Të dhënat në shifra sipas funksioneve dhe zërit të shpenzimit:

funksioni 912	Shuma në lekë
Pagat nga Granti	4 907 832
Pagat nga Te ardhurat	0
Paga nga Transferta sektoriale	72 874 680
Sigurime Shoqërore nga Granti	819 608
Sigurime Shoqërore Transferta sektoriale	12 170 072
Shpenzime operative nga Granti	380 000
Shpenzime operative nga Te ardhurat	1 210 459
Shpenzime operative Transferta sektoriale	19 990 420
TOTALI	112 353 071

funksioni 923 (Arsimi i mesëm)	Shuma në lekë
Paga nga Transferta sektoriale	10 248 710
Sigurime Shoqërore Transferta sektoriale	1 816 125

Shpenzime operative nga Granti	0
Shpenzime operative nga Te ardhurat	310 000
TOTALI	12 374 835

funksioni 923 (Konvikti)	Shuma në lekë
Pagat nga Tranferta sektoriale	18 360 912
Sigurime Shoqerore nga Tranferta sektoriale	3 066 272
Shpenzime operative nga Tranferta sektoriale	3 464 363
Shpenzime operative nga transferta e pakushtezuar	109 429
Shpenzime operative nga Te ardhurat	10 000
TOTALI	25 010 976

funksioni 813	Shuma në lekë
Pagat nga Granti	2 159 240
Pagat nga Te ardhurat	1,347,880
Sigurime Shoqerore nga Granti	585 689
Shpenzime operative nga Granti	800,000
Shpenzime operative nga Te ardhurat	1,650,000
TOTALI	6,542 809

funksioni 822	Shuma në lekë
Pagat nga Granti	10,072 752
Pagat nga Te ardhurat	3,000,000
Sigurime Shoqerore nga Granti	2 183 150
Shpenzime operative nga Granti	174,000
Shpenzime operative nga Te ardhurat	236 000
TOTALI	15 665 902

funksioni 014	Shuma në lekë
Pagat nga Granti	11 771 760
Pagat nga Te ardhurat	5,247,000
Sigurime Shoqerore nga Granti	2 842 133

Shpenzime operative nga Granti(nd.ek fond bashkie)	2 500,000
Shpenzime operative nga Te ardhurat	325,000
TOTALI	22 685 893

funksioni 043	Shuma në lekë
Pagat nga Granti	7 558 400
Pagat nga Te ardhurat	4,000,000
Sigurime Shoqerore nga Granti	1 930 265
Shpenzime operative nga Granti	800 000
Shpenzime operative nga Te ardhurat	196,000
TOTALI	14 484 665

funksioni 476	Shuma në lekë
Pagat nga Granti	2 780 712
Pagat nga Te ardhurat	1,762,320
Sigurime Shoqerore nga Granti	758 686
Shpenzime operative nga Granti	50,000
Shpenzime operative nga Te ardhurat	35,000
TOTALI	5 386 718

Zërat në total për programin:

	Programi AD133	Shuma në lekë
600	Paga	156 092 198
601	Sigurime Shoqerore	26 172 000
602-606	Shpenzime operative	32 240 671
	TOTALI	214 504 869

Sqarojmë se të gjitha keto të dhëna janë edhe analitike në tabelat bashkëlidhur relacionit.

5. PROGRAMI AE133 BUJQESIA, VETERINARIA DHE PYJET

Ky program përfshin funksionet si më poshtë

- funksioni 422 shërbime bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit
- funksioni 424 menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.
- funksioni 426 administrimi i pyjeve dhe kullotave,

Përgjegjës për funksionimin dhe përmbushjen e detyrave të këtij programi është Agjencia e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve

Në këtë program janë funksione që paguhën me transfertën e pakushtëzuar përgjithshme të ardhurat e bashkisë dhe transfertat sektoriale që është :

- Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.....18 789 702 lekë
- Administrimi i pyjeve dhe kullotave22 095 423 lekë

Aktivitetet për përmbushjen e këtij programi janë si më poshtë

Vështrim i përgjithshëm		
Mbështetja e zhvillimit të qendrueshëm të prodhimit bujqësor, mbrojtja e konsumatorëve, menaxhimi i ujitjes dhe kullimit. Administrimi i pyjeve dhe kullotave		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
AE133		• Ngritja, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcele për tokën bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë, përmasat dhe pronësinë e parcelave; • Informacion i përgjithshëm, dokumentacion teknik dhe statistika për çështjet dhe shërbimet bujqësore; • Administrim dhe mbrojtje e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve; • Organizim ose mbështetje e shërbimeve për blegtorinë; • Administrim i shërbimeve të peshkimit dhe gjuetisë; mbrojtje, shtim dhe shfrytëzim racional të peshkut dhe kafshëve të egra; mbikëqyrje dhe disiplinim i peshkimit në ujëra të ëmbla, peshkimit bregdetar, kultivimit të peshkut, gjuetisë së kafshëve të egra dhe liçensave të gjuetisë; • Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural; • Kontrolli ushqimor, mbrojtja e konsumatorit; • Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të administrimit dhe mbrojtjes së tokës. • Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, duke përfshirë grante, hua dhe financime për punime të tilla; • Administrim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit nën përgjegjësinë e njësive të vetëqeverisjes

		vendore. • Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore; • Konservim, zgjerim dhe shfytëzim i racionalizuar i rezervave pyjore; • Administrim i fondit pyjor dhe kullësor publik; • Mbikëqyrje dhe disiplinim i operacioneve pyjore dhe dhënie e liçencave për prerje pemësh; • Organizim ose mbështetje për veprimtarinë rryllëzuese, kontrollin e dëmtuesve dhe sëmundjeve, shërbimet pyjore për luftën kundër zjarrit dhe për parandalimin e zjarrit si dhe ofrimi i shërbimeve për operatorët pyjorë; • Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet pyjore; • Grante, hua ose financime për të mbështetur veprimtaritë tregtare pyjore; • Shpërndarja e kullotave, duke përfshirë menaxhimin e kullotjes.
--	--	--

Të dhënat në shifra sipas funksioneve dhe zërit të shpenzimit:

funksioni 422	Shuma në lekë
Pagat nga Granti	12 648 656
Pagat nga Te ardhurat	385 077
Sigurime Shoqerore nga Granti	2 126 985
Shpenzime operative nga Granti	100,000
Shpenzime operative nga Te ardhurat	60,000
TOTALI	15 320 718

funksioni 424	Shuma në lekë
Paga nga Transferta sektoriale	7 331 760
Sigurime Shoqerore Transferta sektoriale	1 224 404
Shpenzime operative Transferta sektoriale	850 000
TOTALI	9 406 164

funkcioni 426	Shuma në lekë
Pagat nga Granti	0
Pagat nga Te ardhurat	3 036 000
Paga nga Transferta sektoriale	16 007 290
Sigurime Shoqerore nga Te ardhurat	507 012
Sigurime Shoqerore Transferta sektoriale	3 327 133
Shpenzime operative Transferta sektoriale	1,761,000
TOTALI	24 638 435

Zërat në total për programin:

	Programi AE133	Shuma në lekë
600	Paga	39 408 783
601	Sigurime Shoqerore	7 185 534
602-606	Shpenzime operative	2 771 000
	TOTALI	49 365 317

Sqarojmë se të gjitha keto të dhëna janë edhe analitikisht në tabelat bashkëlidhur relacionit.

6. PROGRAMI AF133 FONDI REZERVE DHE I KONTINGJENCES

Ky program përfshin fondin rezerve i cili perdoret per Shpenzime te paparashikuara qe dalin gjate zbatimit te buxhetit dhe fondin e kontingjencës perdoret per te mbuluar diferencen e planit te te ardhurave me realizimin

- Fond Rezerve.....3 000 000 lekë
- Fond Kontigjence.....1 000 000 lekë

C. INVESTIMET PER VITIN 2025

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax: (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

Investimet e plasnifikuara për vitin 2026 sipas financimit janë:

-INVESTIME NGA TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME DHE TË ARDHURAT E BASHKISË

Nr	Emertimi	Shuma në lekë
1	Fond emergjence per investime	3 000,000
2	Blerje dhe mirmbajtje pajisje kompjuterike	300 000
3	Projekte per objekte qe do te ndertohen	5,000,000
4	Rikonstrukcion çatie shkolla Reps	500 000
5	Materjale ndertimi per sherbime publike varreza	8 200 000
6	Shtresa asfaltik dhe paraasfaltik rruge urbane	10,000,000
7	Asfalt dhe Shtresa parasfaltike (Rruge rurale)	37 000 000
8	Blerje kosha mbeturinash	900 000
9	Rikonstrukcion dritare shk 9-vjeçare Rubik	300 000
10	Blerje kondicionere kopeshti pa drake Rubik	200 000
11	Investime Muzeu muzealizim	1,000,000
12	Investim fusha e futbollit Rreshen	3,000,000
13	Mbarshtrimi i pyjeve	8,502,000
14	Blerje soba drushe per shkollat	300 000
15	Blerje frigorifer konvikti Rreshen	50 000
16	Mobilimi I zyrave sektori pyjore	300 000
17	Blerje pajisje kompjuterike APPM	300 000
	TOTALI	78 852 000

Segmentet e rrugëve të cilat do të rikonstruktohen , asfaltohen, riparohen shtresat asfaltike, mirmbahen me shtresa parasfaltike, si rrugë urbane apo edhe rrugë rurale, përcaktohen sipas gjendjes faktike të rrugëve dhe situatave imedjate që mund të paraqiten gjatë punës së vitit ushtrimorë 2026, për ofrimin e shërbimeve sa më efikase dhe qasjes ndaj komunitetit .

Në zërin e investimeve janë parashikuar blerje materjale për ndërhyrjen në infrastrukturën e bashkisë siç është në tabelën më lart, ku puna do të bëhet me punonjësit e APPM-së.

Ky proces ka bërë që të kemi kurse në fonde sepse nuk prokurojmë çdo objekt që do të rikonstruktojmë apo mirmbajmë, por prokurohen vetëm blerja e mallrave, duke shmangur ndikimin

financiarë në buxhetin tonë të tvsh dhe të tatim fitimit për secilin objekt që do prokurohej, vlerë e cila është e kursyer.

Këto shërbime pastaj përkthehen në investime për bashkinë në shërbim të komunitetit.

-INVESTIME NGA TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE

Nr	Emertimi	Shumaneleke
1	Investime Kanali Tarazh(tuba vija vadites)	500,000
2	Invest vepra ujore, tuba vija vadites+mbikqyrje kolaudime	8 683 538
3	Mobilimi I zyrave sekt.vaditjes	100 000
4	Pajisje komp sekt vaditjes	100 000
5	Mbarshtim pyjesh	1 000 000
	TOTALI	10,383 538

D. NË KËTË BUXHET JANË TË PËRFSHIRA EDHE ZËRAT E MËPOSHTËM:

- Paga keshilltare dhe kryetar fshatrash.....18 812 000 lekë (është i përfshirë në programin AA133 Aparati dhe Drejtimi i Bashkise, në funksionin 111)
- Fond i emergjences.....1 500 000 + 3 000 000 fond emergjence për investime në raste emergjente leke dhe pjesa tjetër e këtij fondi, në masën 3% do të çëlet nga MB)
- Pagesë fond ndihme ekonomike.....4 500 000 leke(nga buxheti i bashkise)

SHPENZIMET SIPAS TRANSFERTE E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME, TE ARDHURAT, TRANSFERTE SEKTORIALE

		Transferte e pakushtezuar e përgjithshme	Te Ardhurat e bashkisë	Transferte e pakushtëzuar Sektoriale	TOTALI
600	Paga	207 836 123	47 884 810	177 894 910	433 615 843
601	Sigurime Shoqerore	46 172 619	507 012	26 356 560	73 036 191
602	Shpenzime operative	39 820 445	21 619 178	31 110 448	96 550 071
231	Investime	60 732 000	18 120 000	10 383 538	89 235 538
604	Fond Rezerve + kontigjence+emergjence	4,000,000			4,000,000
	TOTALI	358 561 187	88 131 000	245 745 456	692 437 643

-Analiza e pagave te transfertes se pakushtezuar dhe te ardhurave te veta te Bashkise

-Pagat e stafit dhe agjencive te bashkise nga transferta e pakushtezuar dhe te ardhurate te veta jane ne vleren.....**255 720 933 leke**

-Sigurimet shoqerore dhe shendetesore stafit dhe agjncive te bashkise nga transferta e pakushtezuar dhe te ardhurate veta jane ne vleren.....**46 679 631 leke**

Ne vlere totale paga dhe sigurime jane **302 400 564 leke**, ne te cilat efekti i rritjes se pages sipas vkm nr 503, dt.01.08.2024 “Për disa ndryshime në vendimin numër 328, datë.31.05.2023 të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” është **80 103 125 leke** dhe e llogaritur ne % ndaj totalit te pagave dhe sigurimeve është 26.49%, qe zen kjo vlere.

Nga Ministria e Financave , Drejtoria e Pergjithshme e Financave Vendore me shkresen e çeljes se fondeve te buxhetit te vitit 2026 ne zerin “Rritja e nivelit te pagave” është akorduar fond ne shumen **66 741 320 leke**, ndersa diferenca ndermjet shumes se zene ne buxhetin e bashkise per pagat dhe sigurimet dhe shumes se çelur nga MF **(80 103 125 -66 741 320) prej 13 361 805 leke perballohet nga te ardhurat e veta te bashkise.**

Per te nxjerr kete efekt te ndikimit te rritjes se fondit te pagave ne buxhetin e bashkise është marre si pike referimi buxheti fillestar i **vitit 2023**, sepse pagat kane qene te pa rritura.

SHPENZIMET SIPAS STRUKTURAVE BUXHETORE PËR TRANSFERTËN E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME , TRANSFERTËN SEKTORIALE DHE PLANI E TË ARDHURAVE NË %

1. PAGAT DHE NIVELI I RITJES PAGAVE.....	62.05%
2. SIGURIMET DHE NIVELI I RITJES PAGES.....	10.55%
3. SHPENZIME OPERATIVE.....	13.94%
4. INVESTIME.....	12.88 %
5.FOND EMERGJENCE,REZERVE, KONTINGJENCE.....	0.58%

SHPENZIMET SIPAS STRUKTURAVE BUXHETORE PËR TRANSFERTËN E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME DHE PLANI E TË ARDHURAVE NË %

1. PAGAT.....	42.54%
2. SIGURIMET.....	7.02%
3. SHPENZIME OPERATIVE.....	14.6%
4. INVESTIME.....	17.65 %
5.FOND REZERVE, KONTINGJENCE.....	0.89%
6.NIVELI I RITJES PAGAVE.....	14.1 %
7.SIGURIMET NGA NIVELI I RITJESE SE PAGAVE.....	3.2 %

Ne krahasim me vitin 2025 eshte ulur % e pagave dhe sigurimve dhe jane rritur shpenzimet operative dhe investimet

Bashkia nga buxheti i saj do të mbulojë shpenzimet për karburant sipas kalendarit të ndeshjeve, siguracion jete, federimin, pjesmarrje në kualifikim e dy ekipeve sportive:

1. Ekipi Mirdita Volejboll për Femra të rritura,
2. Ekipi Volejbollit për femra të rejtat.

Të gjitha të dhënat janë hedhur në tabelat përkatëse të buxhetit sipas strukturave.

Per hartimin e draft buxhetit te vitit 2026 jane bere ne te gjitha njesite degjesat publike.

Te dhenat sipas zerave ne vlere dhe ne % per pba 26-28 jane si me poshte

2026

Emertimi i shpenzimit	Shuma ne leke	%
Paga dhe sigurime	506 652 034	73.17%
Shpenzime Operative	87 630 071	12.65%
Investime	89 235 538	12.88%
Fond i Emergjences	1 500 000	0.22%
Fond Rezerve dhe Kontigjences	4 000 000	0.58%
Totali	692 437 643	

2027

Emertimi i shpenzimit	Shuma ne leke	%
Paga dhe sigurime	521 722 455	73.76%
Shpenzime Operative	98 876 016	13.92%
Investime	81 157 538	11.48%
Fond i Emergjences	2 000 000	0.28%
Fond Rezerve dhe Kontigjences	4 000 000	0.56%
Totali	707 256 009	

2028

Emertimi i shpenzimit	Shuma ne leke	%
Paga dhe sigurime	523 382 555	71.91%
Shpenzime Operative	103 121 591	14.17%
Investime	95 299 538	13.10%
Fond i Emergjences	2 000 000	0.27%
Fond Rezerve dhe Kontigjences	4 000 000	0.55%
Totali	727 803 684	

Pergatit relacionin

Pergj.sekt finance/buxhet

Flora FUFU

Dr.zhvill.ekon.tatim.taksave

Vjollca Gjoka



KRYETARI

Albert MËLYSHI

